

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Janar 2019



Ekspozohen të dhënat e hetimeve të FBI.

Javën e fundit ka ndodhur ekspozimi i 3 terabyte të dhëna sensitive që i përkasin Departamentit të Sigurisë në Oklahoma.

Të dhënat ishin marrë nga një server, dhe dobësia u zbulua nga kompania UpGuard.

Në përgjigje të incidentit të ndodhur, Komisioni i Sigurisë në Oklahoma publikoi një deklaratë për shtyp, duke e konsideruar ngjarjen si vulnerabilitet aksidental që ndodhi për një kohë të shkurtër dhe u rikuperua shpejt.

Komisioni tha gjithashtu se departamenti i sigurisë është duke njoftuar të gjithë personat që kanë pasur ekspozim të dhënash, dhe është duke rishikuar procedurat e brendshme të kontrollit, si dhe masat e sigurisë, për tu siguruar që incidente të tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

<https://thehackernews.com/2019/01/oklahoma-fbi-data-leak.html>



Hackerat infektjnë faqet e-commerce.

Grupi i hackerave Magecart ka sulmuar sërish faqet e-commerce. Sipas RiskIQ dhe Trend Micro, hackerat e Magecart kanë arritur të kompromentojnë në mënyrë të suksesshme 277 website e-commerce.

Sulmi ishte realizuar përmes kodeve JavaScript në faqe të ndryshme, të cilat kopjoni të dhënat me të cilat klientët realizonin pagesën, dhe më pas i dërgonte këto të dhëna në serverin e sulmuesit.

<https://thehackernews.com/2019/01/magecart-hacking-credit-cards.html>



Kompromentimi i të dhënave të fluturimit të klientëve.

Thujse gjysma e udhëtarëve në gjithë botën u ekspozuan ndaj një vulnerabiliteti kritik në sistemin e biletarisë online. Hackerat arritën të manipulojnë të dhënat e fluturimit dhe të përvetësojnë mijet e klientëve.

<https://thehackernews.com/2019/01/airlines-flight-hacking.html>

PËRMBAJTJA:

- Kompromentimi i të dhënave
- Siguria në e-commerce
- Siguria e infrastrukturave kritike
- Aktivitete të AKCESK



Kick off meeting i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike

Në kuadër të procesit për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, me miratimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 173, datë 09.11.2018, për ngritjen e grupit ndër-institucional të punës, u zhvillua takimi i parë i grupit ndër-institucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.



Takim me infrastrukturat potenciale kritike të informacionit në e-health

Në kuadër të ndryshimit që kërkohet të bëhet për VKM Nr. 222/2018, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", u zhvillua takimi me përfaqësues të infrastrukturave të Spitaleve Private, me përfaqësues të institucionit të AMF-së dhe ISSH-se të cilët morën përsipër që brenda muajit shkurt 2019, të realizojnë vlerësimin e sistemeve të tyre sipas metodologjisë së miratuar.



Audit i masave të sigurisë

Auditim nga stafi AKCESK pranë operatorëve të infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme, mbi implementimin e masave minimale të sigurisë, të miratuara nga Rregullorja mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë. Ka përfunduar procesi i auditimit dhe dorëzuar draft raporti përfundimtar pranë Bankës Intesa San Paolo dhe është në proces Auditimi Banka e Shqipërisë.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dhe në partneritet me UNICEF, organizojnë "Safer Internet Day", me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë në internet dhe rritjen e nivelit të sigurisë në Infrastrukturat Kritike të Informacionit.